



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT**  
NJËSIA E PROKURIMIT

Burrel, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E THJESHTUAR – SHËRBIME”**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

*“Shërbim transporti materialesh sipas marrëveshjes me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në Bashkinë Mat”, – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj.*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**60000000-8** Shërbime të transportit (përveç transportit të mbeturinave).

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**1 640 000** (një milion e gjashtëqind e dyzet mijë) **lekë pa TVSH**, nga granditë bashkisë në vlerën: 833 333.33 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, dhe nga të ardhurat: 806 666.67 (tetëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c, dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/ enti kontraktor **Bashkia Mat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

## **2. Kandidati/ Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 të DST-së.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.** Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar

kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë: **c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.**

3. **Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.**

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohe në raport me objektin e prokurimit, **duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.**”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë në një vlerë, jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, vlerë kjo e kërkuar brenda masës së përcaktuar në dispozitat nënligjore të sipërcituara, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

**Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.**

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj marrëveshje kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/c dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale**;... 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të

*përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”*

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 3** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

**“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

**Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.**

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”**

Ndërsa në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

*Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

**Njësia përcaktoj kriteret për shërbime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.**

**Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 41 që provon kryerjen e shërbimeve të ngjashme në masën e përcaktuar në pikën 4/b të nenit 55.**

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licencë për transportin e mallrave me qira dhe për të tretë brenda vendit sipas ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar), dhe VKM-së nr.325, datë 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në

veprimitarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë” (i ndryshuar).

### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) **përshtatshmërinë për të kryer veprimitarinë profesionale**;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/a** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimitarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se, referuar natyrës dhe sasive të mallrave/ materialeve ndërtimore për të cilat kërkohet kryerja e shërbimit të transportit, në mbështetje të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar), neni 1/b, 3/3.14, 39, dhe 41 i tij, përcaktohet se, citojmë: “...1/b) Ky ligj do të zbatohet, gjithashtu, për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të mallrave për të tretë, me qira ose për nevojat e veta brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë...3/3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira... 39. Transporti i mallrave brenda vendit dhe ai ndërkombëtar është transporti që kryhet nga shoqëri transporti, persona fizikë ose filiale të shoqërive tregtare, shoqëruar me dokumentet përkatëse dhe ato suplementare që përcaktohen me dispozita të veçanta të Këshillit të Ministrave. 41. Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.325, datë 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimitarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë” (i ndryshuar), pika 2.1 e tij, në të cilën përcaktohet se, citojmë: “...2.1 Transporti i mallrave dhe udhëtarëve lejohet të kryhet, nga ndërmarrje të transportit, për të tretë ose me qira, vetëm kur janë pajisur me: a) **licencën përkatëse në transportin rrugor, për të tretë ose me qira, të mallrave ose udhëtarëve, brenda vendit;**” dhe Udhëzimit Nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar), njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë licencën për transportin e mallrave me qira dhe për të tretë brenda vendit, me qëllim kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, pasi në të kundërt nuk mund ta ofrojnë këtë shërbim.**

**Njësia e prokurimit përcaktoj kriterin për kapacitetin profesional si më lart duke qënë se ky kriter është i detyrueshëm, në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.**

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi **2 (dy) drejtues të mjeteve të rënda**, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë/ subjektit të punësuar për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit në rastin kur mjetet e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, dhe në çdo rast, *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit*, për secilin të paraqiten:

- Kontratë Individuale e Punës (*të vlefshme*),
- Leje drejtimi e kategorisë CE,
- Çertifikatën e Aftësisë Profesionale përkatëse (CAP)
- Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1 dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. **4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/b** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**4. Për të provuar përshatshmërinë për të**

*kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:... b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...*”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit vlerëson se, me qëllim kryerjen e shërbimit të transportit objekt prokurimi, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë pjesë të stafit të tyre minimumi **2 (dy) drejtues të mjeteve të rënda**, kërkesë e cila, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 41 pika 4/b të VKM-së, ku numri i drejtuesve të mjeteve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e stafit të drejtuesve që nevojitet për realizimin e shërbimit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 5 “*Formulari i specifikimeve teknike*” dhe llojit të transportit që do të kryhet, për të cilin kërkohet shërbimi objekt prokurimi, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, nenit 115 dhe 115/1 pika 6 i ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat vërtetojnë **aftësinë e stafit që do të angazhohet për kryerjen e shërbimit (Leje drejtimi dhe Çertifikatën e aftësisimit profesional)** dhe **disponimin/punësimin e tyre (kontratë, listëpagesa)**, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në personelin që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

**Stafi i drejtuesve të mjeteve i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t’u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.**

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi **2 (dy) automjete me kapacitet mbajtës jo më pak se 15 ton**, të cilët duhet t’i ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilat duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, dhe Çertifikatën për transport mallrash. Në rast se automjeti disponohet me qira/huapërdorje, duhet të paraqitet dhe kontrata përkatëse e qirasë/ huapërdorjes, në emër të subjektit,



të lidhura para noterit dhe afati i së cilës të përfshijë periudhën e marrëveshjes kuadër objekt prokurimi.

Disponimi i automjeteve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** pika **1** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. **4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/ç** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...** ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriterë janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriterë, janë kriterë detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë numrin automjeteve me kapacitetin mbajtës të kërkuar (*jo më pak se 15 ton*), **të cilat janë të nevojshme për kryerjen e transportit të mallrave/ materialeve objekt prokurimi**, ku sasia dhe kapaciteti mbajtës i tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e kontratës objekt prokurimi, pasi pa këto automjete nuk mund të realizohet transporti i këtyre mallrave/ materialeve të ndërtimit. Njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët

ekonomik pjesëmarrës me qëllim vërtetimin e disponimit të tyre, dhe dokumentacionin tekniko-ligjor të tyre të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik për qarkullimin e tyre.

### **Shënim:**

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Referuar shërbimit që kërkohet të kryhet, atij të transportit të mallrave, bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga Komisioni për Përcaktimin e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike/Bashkia Mat, duke qënë se ato, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik<sup>1</sup>”, dhe nenit 41 pika 1 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për shërbimin objekt prokurimi.

- **Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.**
- **Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.**
- **Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë data 15.04.2024, ora 10.<sup>00</sup>, vendi: në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) .**

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

## **NJËSIA E PROKURIMIT**